

Përshëndetje,

lidhur me informacionin e kërkuar, sqarojme se:

Në fushën e kujdesit paliativ vepron Ligji nr. 138, datë 16.10.2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”.

Fondi lidh kontratë me QSH SOB për financimin e shërbimeve shëndetësore të specializuara nga QSH- SOB në kujdesin shëndetësor parësor të rrethit të Tiranës, për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali deri në fund të jetës së tyre (kujdes paliativ).

Fondi lidh kontratë me organizatat jo fitimprurëse Ryder për njohjen nga Fondi e së drejtës së lëshimit të recetës me rimbursim, nga mjeku i organizatës jofitimprurëse i certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ofrimin e kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali e në vazhdim.

Për rajonet që nuk ka ofrues privat të shërbimit paliativ, ndjekja dhe lëshimi i recetes bëhet nga mjeku i familjes.

Cdo spital ka ngritur dhe funksionon shërbimi paliativ për pacientët, që kanë nevojë për kujdespaliativ me disa shtretër dhe personel shëndetësor që asiston pacientët. Barnat që nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, janë barnat e “listës esenciale” të kujdesit paliativ dhe sigurohen nga farmacia e Spitalit.

Ne statistikën që Fondi mbledh, nuk disponon numër pacientësh.